



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

[Datë 02.11.2021]

Formulari nr. 3

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Tiranë
Adresa	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
Tel/Fax	0035542256799
E-mail	administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit	www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 1 (një) bilete udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë Berlin/Leipzig, Gjermani–Tiranë”**.

Data e zhvillimit do të jetë **02.11.2021 ora 15.20** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

- **Itinerari: Tiranë- Berlin/ Leipzig, Gjermani -Tiranë**
- Nisja nga Tirana drejt Berlin do të bëhet në datën 03.11.2021 pasdite, mbërritja para orës 21.30. Pa ndalesë
- Kthimi nga Leipzig drejt Tiranës do të bëhet në datën 04.11.2021 në darkë, nisja pas orës 20.00, mbërritja gjatë mesnatës. Me një ndalesë
- Bagazhe të përfshira

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.

**Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: administrative.prokurime@tirana.al) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.